



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, dt. 4 qershor 2008), neni 2 dhe neni 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal, nr. 03/L-049 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosova, nr.27/15 qershor 2008), neni 34, paragrafi 34.1 shkronja c, të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 09.10.2017, miratoi këtë

**R R E G U L L O R E**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA,  
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01 NR .110-2782, DT. 02.12.2011**

Shprehjet e përdorura në vazhdim kanë këtë kuptim:

**Pronë e paluajtshme** - toka dhe ndërtesat nën dhe mbi sipërfaqen e tokës dhe që janë të lidhura me tokën, e cila është objekt i transaksionit.

**Njësi** - paluajtshmëria e cila ngarkohet me taksë në transaksion.

**Person fizik/juridik** - titullari i së drejtës mbi pronën e paluajtshme, në cilësinë e taksapaguesit.

**Neni 1**

Neni 4 i Rregullores, ndryshon si në vijim:

**Tarifa e taksës në transaksionin për pronën e paluajtshme**

1. Një njësi llogaritet në vlerë prej 150 €;
  - 1.1. Ndërtesa në sipërfaqe deri në 100 m<sup>2</sup> llogaritet një njësi.
  - 1.2. Ndërtesa në sipërfaqe mbi 100 m<sup>2</sup> deri 200 m<sup>2</sup> do të llogaritet me dy njësi, mbi 200 m<sup>2</sup> deri në 300 m<sup>2</sup> llogaritet tri njësi e kështu me radhë sipas sipërfaqes së objektit.
  - 1.3. Tokë në sipërfaqe deri 10000 m<sup>2</sup> llogaritet një njësi.
  - 1.4. Tokë mbi sipërfaqe 10000 m<sup>2</sup> deri në 20000 m<sup>2</sup> llogaritet dy njësi, mbi 20000 m<sup>2</sup> deri 30000 m<sup>2</sup> llogaritet tri njësi e kështu me radhë sipas sipërfaqes së tokës.



2. Kur një person fizik/juridik e fiton të drejtën e pronësisë me një akt juridik, do të caktohet lartësia e taksës në vlerë prej 150 € për njësi.
3. Kur dy e më shumë persona fizikë/juridikë e fitojnë të drejtën e pronësisë me një akt juridik, do të caktohet lartësia e taksës në vlerë prej 150 € për secilin person veç e veç dhe secilën njësi.
4. Në rastin e regjistrimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, bashkëshortët paguajnë bashkërisht për një njësi.
5. Drejtoria kompetente nxjerr Vendim për tarifën e taksës në transaksion për pronën e paluajtshme pas kërkesës së palës.

## Neni 2

### Aktet juridike përmes të cilave personat fizikë/juridikë kanë fituar të drejtën pronësore dhe ngarkohen me taksë në transaksion

1. Taksa në transaksion caktohet në pronën e paluajtshme për personin fizik/juridik, si në vijim;
  - 1.1. Personi fizik/juridik që e fiton të drejtën në pronën e paluajtshme sipas akteve juridike, aktgjyqimeve, vendimeve, aktvendimeve mbi trashëgimin, mbajtjen e përjetshme, testamentin, shkëputjen e bashkësisë familjare, kontratën mbi dhuratën, faljen dhe akteve të tjera, do të caktohet lartësia e tarifës së taksës në transaksion sipas nenit 1, për radhën e dytë dhe të tretë të trashëgimisë, sipas Ligjit të trashëgimisë.
  - 1.2. Personi fizik/juridik që fiton të drejtën e paluajtshmerisë sipas akteve juridike mbi bazën e shitblerjes, këmbimit, ndërrimit, kompozimit e të ngjashme, do të caktohet lartësia e tarifës në transaksion sipas nenit 1.
  - 1.3. Personi fizik/juridik që fiton të drejtën e shfrytëzimit qirambajtje/qiramarrje 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet, do të caktohet lartësia e tarifës në transaksion sipas nenit 1.
  - 1.4. Secili person fizik/juridik që hyn në bashkëpronësi, do t'i caktohet lartësia e tarifës në transaksion sipas nenin 1, për pjesën ideale/pjesën e pronës në sipërfaqen e përgjithshme për secilën njësi.
  - 1.5. Personat fizikë/juridikë që themelojnë/krijojnë bashkëpronësi, do t'i caktohet lartësia e tarifës në transaksion sipas nenit 1, për pjesën ideale/pjesën e pronës në sipërfaqen e përgjithshme për secilën njësi.
  - 1.6. Kur me një akt juridik kryhen dy e më tepër veprime për njësinë kadastrale të njëjtë, e që janë të cekura në dispozitat e nënparagrafit 1.4 dhe 1.5, secilit person fizik/juridik do t'i caktohet lartësia e tarifës në transaksion sipas nenit 1, vetëm për themelimin/krijimin e bashkëpronësisë, sipas dispozitës së nënparagrafit 1.5.



1.8. Personat fizikë/juridikë që shkëpusin bashkëpronësinë, bëjnë ndarje fizike e të ngjashme, do t'i caktohet lartësia e tarifës në transaksion sipas nenit 1 për pjesën ideale/pjesën e pronës në sipërfaqen e përgjithshme për secilën njësi. Ndërsa personat fizikë/juridikë që mbeten në bashkëpronësi në parcelën kadastrale/njësinë kadastrale të njëjtë nuk do të caktohet taksa në transaksion.

### Neni 3

#### Lirimi nga taksa e transaksionit në pronën e paluajtshme

1. Personi fizikë/juridikë që e fiton të drejtën në pronën e paluajtshme sipas akteve juridike; aktgjykimeve, vendimeve, aktvendimeve mbi trashëgiminë, mbajtjen e përjetshme, testamentin, shkëputjen e bashkësisë familjare, kontratën mbi dhuratën, faljen si dhe akteve tjera, lirohen nga caktimi i tarifës së transaksionit vetëm radha e parë e trashëgimisë, ku hyjnë pasardhësit dhe bashkëshorti/ja, si dhe kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij trashëgojnë fëmijët e tij, të cilët llogariten si radhë e parë e trashëgimisë.
2. Institucionet dhe organizatat e mëposhtme lirohen:
  - 2.1. Institucionet e Republikës së Kosovës;
    - 1.1. Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian;
    - 1.2. Forca shumëkombëshe e Kosovës (KFOR-i, ICO dhe EULEX), përfaqësitë diplomatike dhe konsullatat e akredituara në shtetin e Republikës së Kosovës.
3. Rastet tjera që parashihen me ligje të veçanta.

### Neni 4

#### Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-431/04-0253531/17, më 10.10.2017

KRYESUESI I KUVENDIT  
Halim Halimi, jur. i dipl.

